

VENDIM
Nr. 298, datë 5.4.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.926, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE, QË PRIVATIZOHET APO TRANSFORMOHET, DHE PROCEDURËN E SHITJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të aktit normativ nr.4, datë 9.7.2008, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, të kreut I, fjalët "...dhe mjetet e xhiros..." zëvendësohen me "...mjetet e xhiros dhe aktivet biologjike...".

2. Në kreun II bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 4 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Nëse, pas hartimit të genplanit nga ekspertët vlerësues, rezultojnë sipërfaqe truall të lira (më shumë se sipërfaqja nën objekt dhe ajo funksionale), institucioni administrues, në zbatim të procedurave ligjore përkatëse, ia kalon ato Agjencisë së Trajtimit të Pronave, për përdorimin për fond kompensimi për ish-pronarët ose për kthim fizik."

b) Në pikën 18, fjalia e parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Në rastet kur në përbërje të pronës që privatizohet nuk ka objekte ndërtimore sipërfaqësore, por vetëm objekte ndërtimore nëntokësore (tunele), atëherë vlerësimi, për efekt privatizimi, do të bëhet vetëm për objektin (strukturën ndërtimore), pa truall, sipas dokumentacionit ligjor përkatës (listë inventari, vendim i Këshillit të Ministrave, etj.) të institucionit administrues/pronar."

3. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Fjalët "...gazetë me qarkullim kombëtar..." zëvendësohen me "... Buletinin e Njoftimeve Zyrtare...";

b) Në fund të paragrafit të parë, të pikës 16, shtohen fjalët "...dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave...";

c) Në fund të paragrafit të parë, të pikës 24, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur nuk respektohet afati 30 (tridhjetë) ditë i pagesës së vlerës së plotë të objektit bashkë me truallin, për arsye objektive të justifikuara, me autorizim të drejtorit të Drejtimit të Pronës Publike afati zgjatet, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga përfundimi i afatit tridhjetë ditë."

ç) Në pikën 26, në fund të fjalëve "... brenda 30 (tridhjetë) ditëve pjesën e mbetur të çmimit të arritur në ankand..." shtohen "... (përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë vendim)..."

4. Kudo në vendim, emërtesa "Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave" zëvendësohet me "Agjencia e Trajtimit të Pronës".

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

